



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme/Kancelarija Stalnog Sekretara/Office of the Permanent Secretary

Nr. 150 /2025
Datë: 24/11 /2025

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 mars 2019), në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-048 mbi menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, bazuar në nenin 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 3 dhe 8 (paragrafi 4 dhe 5) të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore si dhe në përputhje me Rregullat e Brendshme Nr. 02-214 për menaxhimin e pasurisë Jo Financiare të Ministrisë së Drejtësisë, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për pranimin teknik të Pasurisë jo Financiare sipas kontratës me titull "Furnizime dhe shërbime të ndryshme kontraktuese për mbajtjen e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore", me numër të kontratës: 215-25-8124-1-2-1/C142, në këtë përbërje
 - 1.1. Edona Berisha, Zyrtare e Lartë për Mbështetje të Viktimave të Krimit DDTMVK, kryesuese;
 - 1.2. Valon Grashtica, Zyrtar i Lartë i Prokurimit MD, anëtar
 - 1.3. Valdona Bytyci, Zyrtar i Lartë për Drejtësi Tranzicionale, DDTMVK, anëtar
2. Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi obligohet të zbatojë detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke verifikuar artikujt sipas specifikave teknike të dosjes së tenderit dhe në koordinim me menaxherin e kontratës dhe përfaqësuesin e furnizuesit.
3. Pas verifikimit, komisioni harton procesverbalin ku përshkruan gjendjen faktike, përputhshmërinë me kërkesat teknike ose mangësitë e konstatuara, duke caktuar afatin për mënjanimin e tyre nëse ekzistojnë. Në rast se nuk ka të meta, komisioni lëshon formularin e pranimit teknik dhe ia dërgon kontraktuesit, ndërsa një kopje ia përcjell Zyrës së Prokurimit për procedim të mëtejshëm.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Kabinetit të Ushtruesit të detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Divizionit të Prokurimit;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.